



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË
ORGANIZUAR**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 18.06.2025

- Lënda:** Bisedimet përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen me objekt: Ankim kundër vendimit nr. 600, datë 19.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Robert Kote.
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 dhe 8 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese

Të nderuar gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit!

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, pasi u shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor të gjitha kërkimet dhe propësimet e palëve, si dhe provat e administruara në kuadër të këtij gjykimi, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në referencë të përmbajtjes së akteve të administruara dhe nivelit të provueshmërisë së tyre në lidhje me shkaqet e ankimit, parashtron si vijon:

1. Për pasurinë “autoveturë” me targë: ** * ** , marka “Audi A4”,** gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera ka deklaruar se: [...] *balanca negative dhe pamjaftueshmëria financiare, në momentin e blerjes së automjetit, datë **08.2014, ka ardhur si rrjedhojë e mosnjohjes së fitimit nga shitja e automjetit Rover, të cilat sipas praktikës së Kolegjit, ato konsiderohen të ardhura të ligjshme si dhe pasaktësive të gjendjes së cash-it në deklarimet periodike të periudhave të kaluara [...],* ndërsa nuk ka depozituara akte të reja lidhur me këtë shkak ankimi.

1.1 Referuar jurisprudencës së cituar nga subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e tij, konkretisht në vendimin Nr. 26/2023 (JR) datë 03.07.2023, paragrafi 12.5, Kolegji ndër

Faqe 1 nga 8

të tjera ka vlerësuar: [...] të konsiderojë të ligjshme të ardhurat e krijuara prej shitjes edhe të këtij automjeti, sa kohë që Komisioni nuk ka ngritur dyshime mbi fiktivitetin e çmimit të blerjes apo shitjes së tij [...].

1.2 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në referencë të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit z. Robert Kote, të depozituara prej tij në Kolegj, vlerëson se edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën lidhur me pamjaftueshmërinë financiare në vlerën -783.737 lekë, të konstatuar nga Komisioni për mbulimin me burime të ligjshme të pasurisë autoveturë, me targë
* * * * *

1.3 Gjithashtu konstatojmë se edhe në konsideratë të pretendimeve të subjektit për përfshirjen në mesin e burimeve të ligjshme të shumës së plotë të përfituar nga shitja e automjetit tip Rover në vlerën 4.000 euro, përsëri do të rezultonte mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e automjetit objekt analize, por në këtë rast pamjaftueshmëria do të llogaritej në vlerën rreth - 400.000 lekë, balanca negative këto që duhen marrë në konsideratë në vlerësimin e kriterit të pasurisë.

2. Lidhur me shpenzimet e shkollimit dhe të jetesës për personin e lidhur, znj.

* * * * *, vajza e subjektit të rivlerësimit në Austri, subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e depozituara në Kolegj, me datë *.06.2025, regjistruar me nr. ***/** prot., ndër të tjera ka deklaruar: [...] Vajza * * * * * nuk filloi studimet e larta në Vjenë, Austri. Gjatë periudhës së qëndrimit ka ndjekur kursin e gjuhës dhe është kthyer përfundimisht në Shqipëri ... Gjatë vitit 2015, vajza * * * * * ka qëndruar rreth 172 ditë në Austri. Në vitin 2016 ka qëndruar 149 ditë dhe në vitin 2017 ka qëndruar 107 ditë ... Për të vërtetuar këtë fakt, ju paraqes në cilësinë e provës së re emailin e datës *.07.2017, nëpërmjet të cilës Universiteti informon se për shkak të mosparaqitjes në provimin pranues, datë *.07.2017, vajzës nuk i është dhënë e drejta e fillimit të studimeve për vitin akademik 2017-2018 [...].

2.1 Bashkëlidhur këtyre parashtrimeve subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në cilësinë e provës aktet si vijon:

2.1.1 Deklaratë noteriale nr. *** rep. dhe nr.*** kol., datë*.6.2025, me anë të së cilës subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] kam kontaktuar me vajzën time * * * * * ; e cila më ka dërguar me foto (pamje të ekranit për e-mailin e saj/screenshot) nga e-maili i saj në celularin tim nëpërmjet platformës Ëhatsapp me nr. *** , e-mailin që vajzës time * * * * * , i ka ardhur nga * * * * * @*** me subjekt: Procedura e pranimit për Programin Bachelor në Biznes, Ekonomi dhe Shkenca Sociale, të përkthyer nga përkthyesi zyrtar për gjuhën gjermane, * * * * * , i licencuar nga Ministria e Drejtësisë.

Printim i të dhënave të komunikimit midis e-mailit të vajzës timë * * * * * tek ehatsapp i celularit tim, e-maili i ardhur në adresën e vajzës time (e-mailin e saj) nga

adresa ***@***.*** drejtuar asaj, me dy printime, e cila (vajza ime *** ***) siç edhe më ka deklaruar edhe më përpara që studimet në këtë degë as nuk i filloi pasi nuk mori as pjesë tek provimi i pranimit [...].

2.1.2 Bashkëlidhur kësaj deklarate subjekti i rivlerësimit ka depozituar një e-mail, në përmbajtjen e të cilit, ndër të tjera citohet: [...] I/E nderuar aplikant studimesh. Ju keni përfunduar me sukses fazën e procesit të pranimit (letrën e motivimit) dhe jeni ftuar në provimin pranues të martën, më ** korrik 2017. Megjithatë nuk u paraqitët në provimin pranues, me keqardhje ju informojmë se nuk jeni i/e kualifikuar për të filluar programin Bachelor në Biznes, Ekonomi dhe Shkenca Sociale në Universitetin e Ekonomisë dhe Biznesit të Vjenës në vitin e ardhshëm akademik (semestri dimëror 2017/18 ose semestri veror 2018).

2.2 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në referencë të parashtimeve dhe akteve të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në Kolegj, me datë **.06.2025, regjistruar me nr. ***/** prot., sa më sipër cituar, konstaton se në komunikimin elektronik të depozituar nga subjekti i rivlerësimit dhe të pranuar si provë në këtë proces, konfirmohet se aplikanti nuk është kualifikuar për të filluar programin Bachelor në Biznes, Ekonomi dhe Shkenca Sociale në Universitetin e Ekonomisë dhe Biznesit të Vjenës.

2.3 Referuar këtij akti të ri të depozituar nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj dhe në kushtet kur si gjatë hetimit administrativ në Komision ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, nuk rezultoi ndonjë rrethanë e re që të provojë shpenzime të tjera të kryera nga vajza e subjektit të rivlerësimit gjatë qëndrimit të saj në Vjenë, Austri, përveç atyre të konsideruara/përfshira në analizën financiare përfundimtare të kryer nga Komisioni, sipas së cilës pamjaftueshmëria e konstatuar lidhur me shpenzimet e jetesës së vajzës së subjektit në Vjenë, Austri, është llogaritur në shumën -133.127 lekë për vitin 2015, vlerësojmë se kjo diferencë negative duhet marrë në konsideratë në vlerësim të kriterit të pasurisë.

3. **Për pasurinë “autoveturë” me targë: *** ***, marka “Audi A4”,** subjekti i rivlerësimit në parashtimet e depozituara në Kolegj, me datë **.06.2025, regjistruar me nr. ***/** prot., ndër të tjera ka deklaruar: [...] Ky automjet është shitur për shkak të mospërbushjes së pagesës së çmimit të blerjes. Diferenca ndërmjet çmimit të blerjes dhe çmimit të shitjes në shumën 340.000 lekë (1.320.000 – 980.000) është shuma e paguar nga unë subjekti për këtë automjet deri në momentin e shitjes së tij. Arsyeja pse çmimi i shitjes u vendos në shumën 980.000 lekë, është për shkak se kjo ishte vlera e papaguar nga ana ime për blerjen e këtij automjeti. Si burim krijimi për pagesën e shumës 340.000 lekë kanë shërbyer të ardhurat nga paga ime, pensioni dhe të ardhurat e bashkëshortes si dhe tërheqja e diferencës së kredisë në shumën 120.000 lekë (500.000 lekë – 380.000) [...].

3.1 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në referencë të parashtrimeve të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në Kolegj, me datë **.06.2025, ku subjekti ka qartësuar shumën e paguar prej tij për blerjen e pasurinë “autoveturë” me targë ** ***, në vlerën 340.000 lekë, çka përkon edhe me diferencën ndërmjet vlerës së dy kontratave të nënshkruara për këtë pasuri dhe të administruara në dosje¹, në kushtet kur blerja dhe shitja e automjetit është kryer brenda të njëjtit vit deklarues, në një hark kohor 30 ditor, referuar dhe deklarimit të subjektit në deklaratën periodike vjetore për vitin 2016, ku ky i fundit ka deklaruar se automjeti është shitur për mospërmbushje të detyrimeve financiare, vlerëson të arsyeshëm deklarimin e subjektit se shuma 340.000 lekë, është shuma e paguar prej tij për këtë automjet deri në momentin e shitjes së tij.

3.2 Referuar akteve të administruara në dosje, sikurse është analizuar dhe në ankimin e datës 14.2.2023, rezulton se të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur, deri në datën **.6.2016, kur është blerë ky automjet, janë rreth 1.055.000 lekë², ndërsa shpenzimet e periudhës (shpenzime jetese në Shqipëri, shpenzime kredie dhe shpenzime për shlyerje overdraft në *** Bank) përlllogariten më së paku në vlerën 800.000 lekë³. Gjithashtu nga aktet në dosje rezulton se subjekti i rivlerësimit ka marrë një kredi në *** Bank në shumën 500.000 lekë në mars të vitit 2016. Lidhur me këtë kredi në parashtrimet e depozituara në Kolegj, ka deklaruar se tërheqja e diferencës së kredisë në shumën 120.000 lekë ka shërbyer si një nga burimet e krijimit të pagesës 340.000 lekë të kryer për automjetin.

3.3 Sa më sipër duke mbajtur në konsideratë se kredia bankare e marrë në *** Bank ka qenë në shumën 500.000 lekë dhe një pjesë e kësaj kredie ka shërbyer për mbulimin e shpenzimeve të vajzës *** në Vjenë⁴ dhe për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimeve të kryera gjatë kësaj periudhe⁵ sikurse është deklaruar nga subjekti gjatë hetimit administrativ, çmujmë se diferenca ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të konstatuara si më sipër në shumën 255.000 lekë (1.055.000 lekë – 800.000 lekë), së bashku me shumën 120.000 lekë tërhequr nga fondet e kredisë

¹ Në dosje janë administruar: kontrata e datës **.6.2016 për blerjen e automjetit “Audi A4” në vlerën 1.320.000 lekë dhe kontrata e shitjes për të njëjtin automjet me nr. ***/** datë **.7.2016 për vlerën 980.000 lekë.

² Të ardhurat nga paga e subjektit, kredituar në *** Bank janë rreth 735.000 lekë; të ardhurat e bashkëshortes, kredituar në *** Bank janë rreth 246.000 lekë, të ardhurat nga pensioni i bashkëshortes, sipas shkresës së ISSH-së nr. *** prot., datë **.10.2016, llogariten në vlerën rreth 74.000 lekë. Rezulton që në mars të vitit 2016 është marrë dhe një kredi në shumën 500.000 lekë, në *** Bank.

³ Rezulton që gjatë kësaj periudhe, familja e subjektit të ketë pasur shpenzime jetese në Shqipëri rreth 400.000 lekë, shpenzime kredie rreth 130.000 lekë, si dhe ka bërë një depozitim *cash* në *** Bank, në shumën 270.000 lekë, në datën **.6.2016, për mbyllje Overdrafti.

⁴ Në përgjigje të pyetësorit datë **.5.2022, subjekti ka deklaruar se qëllimi i përdorimit të kredisë është për përballimin e shpenzimeve të qëndrimit të vajzës në Vjenë. Referuar të dhënave të sistemit TIMS vajza e subjektit ka qëndruar në Vjenë gjatë kësaj periudhe gjithsej 79 ditë dhe referuar shpjegimeve të subjektit se shpenzimet mujore kanë qenë 750 euro/muaj, për periudhën e qëndrimit 79 ditë shpenzimet e jetesës llogariten në vlerën rreth 2.000 euro ose rreth 270.000 lekë.

⁵ Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja, në datën **.5.2021, subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar se qëllimi i kredisë në shumën 500.000 lekë marrë në *** Bank ka qenë për pushime dhe udhëtime. Referuar analizës financiare të kryer nga Komisioni rezultojnë se shpenzimet e udhëtimeve të kryera nga familja e subjektit deri në datën **.6.2016 janë rreth 750 euro ose rreth 100.000 lekë.

bankare, vlerësohet se janë të mjaftueshme për të mbuluar pagesën në shumën 340.000 lekë, deklaruar nga subjekti si e kryer në momentin e blerjes së automjetit objekt analize.

4. Duke përfunduar lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, vlerëson se pamjaftueshmëria në shumën -783.737 lekë e konstatuar për pasuritë autoveturë me targë: ** *** **, blerë në vitin 2014 dhe pamjaftueshmëria në shumën -133.127 lekë, e konstatuar lidhur me shpenzimet e jetesës së vajzës së subjektit në Vjenë për vitin 2015, në vlerësim të situatës së çështjes objekt gjykimi, nuk e cenon besueshmërinë e subjektit të rivlerësimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe nuk tejkalon masën e proporcionalitetit të zbatuar deri tani nga Kolegji në raste të ngjashme⁶.

5. Ambient shërbimi me sipërfaqe 68 m², ndodhur në rrugën “* **”, Tiranë**

5.1 Lidhur me këtë shkak ankimi, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, çmon se edhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në Kolegj subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e konstatimit se subjekti ka kryer veprime në dukje fiktive të cilat kanë patur si qëllim përfitimin e kredisë në shumën 30.000 euro nga *** Bank në datën **2.2017 dhe jo blerjen e pasurisë së paluajtshme që është deklaruar në bankë si qëllimi i marrjes së kësaj kredie.

5.2 Nuk rezulton e provuar që subjekti i rivlerësimit të ketë patur dijeni për faktin se shtetasi *** ** (administrator i palës kontraktuese “*** **” sh.p.k., në kontratat e datave **2.2017, **3.2017 dhe **3.2017) ka qenë i dënuar në kohën e lidhjes së kontratës, pasi arrestimi i tij ka ndodhur në datën **07.2017 dhe ky person ka qenë i dënuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, e cila nuk përfshihet në grupin e veprave penale të parashikuara në nenin 3, pika 15 të ligjit nr.84/2016.

5.3 Po kështu, nga verifikimi i akteve në dosje rezulton se edhe procedimet penale për shtetasin *** ** (rezulton si dorëzues në kontratën e hipotekimit të datës **3.2017) me nr. ***/2017 dhe nr. ***/2019 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, janë rregjistruar pas lidhjes së kontratës së hipotekës të datës **03.2017 dhe pas krijimit të marrëdhënies juridiko civile të mësipërme.

6. Sa i takon rrethanave të konstatuara lidhur me kredinë e marrë nga subjekti i rivlerësimit në *** Bank dhe marrëdhënia me shtetasit *** ** dhe *** **, vlerësojmë se nuk ngarkojnë subjektin e rivlerësimit me ndonjë sjellje që duhet parë në vlerësimin tërësor që cënon besimin e publikut te drejtësia, në një masë të tillë

⁶ Referohuni vendimit Nr.4/2024 (JR), datë 30.1.2024; vendimit Nr. 32/2023 (JR), datë 24.7.2023, etj.

që do të justifikonte marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit z. Robert Kote.

7. Për procedimin penal me nr. * , viti 2016,** për kryerjen e veprës penale *“Mbajta pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”* parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal, i regjistruar nga subjekti i rivlerësimit si kundërvajtje penale sipas nenit 278 paragrafi 2 i Kodit Penal në ankimin e Komisionerit Publik të datës 14.02.2023 është parashtruar se:

[...] elementet e këtij procedimi, në raport dhe me gjetjet e tjera, duhen vlerësuar dhe trajtuar si situata, të cilat mund të ndikojnë në cenimin e besimit të publikut, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, duke detajuar

(i) lidhur me nenin 278 të Kodit Penal, vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 9, datë 26.2.2016, me objekt: papajtueshmërinë me Kushtetutën ... e paragrafit të katërt, të nenit 278, të Kodit Penal, është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 31, datë 29.2.2016, rreth 9 muaj nga data e regjistrimit të këtij procedimi penal, kohë e mjaftueshme për magistratët për t'u njohur, analizuar dhe përvetësuar njohuritë e nevojshme të rrjedhura prej tij. Po ashtu, ndryshimet e Kodit Penal në përputhje me këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese janë miratuar me ligjin nr.82/2016, botuar në Fletoren Zyrtare nr.151, datë 11.8.2016, rreth 5 muaj para regjistrimit të procedimit penal objekt vlerësimi, edhe kjo një periudhë kohe e mjaftueshme në aspektin e përvetësimit të njohurive ligjore, për më tepër të një magjistrati prokuror me përvojë;

(ii) lidhur me aspektin e qëndrimit në linjë me atë të oficerit të Policisë Gjyqësore sjellim në vëmendje të Kolegjit se oficerët e Policisë Gjyqësore janë në varësi funksionale të prokurorit dhe është ky i fundit që vlerëson për veprimet hetimore që do të ndërmerren. Si rrjedhojë, pavarësisht nga referimi i OPGJ-së në informacionin e dërguar prokurorit, nuk mund të merret e mirëqenë për t'u regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, pasi është diskrecion i prokurorit ngritja e akuzës në varësi të vlerësimeve të tij në lidhje me rrethanat dhe elementet e veprës penale dhe, për pasojë, edhe regjistrimi i njoftimit të veprave penale, sipas kërkesave të nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale;

(iii) lidhur me atë arsyetim, që vlerësimi ka të bëjë me thelbin e çështjes, vlerësojmë se aspekti i njohurive ligjore të magjistratit prokuror, vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e tij për të hetuar dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit, i cili në rastin objekt vlerësimi, është i papërshtatshëm në raport me elemente të anës objektive të veprës penale, sikurse është sasia e fishekëve e evidentuar në aktet e hetimit, 1.440 fishekë, si dhe gjendja e flagrancës në transportimin e tyre.[...]

7.1 Subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e depozituara në Kolegj në datë ******.06.2025, regjistruar me nr. *******/** prot., ndër të tjera shprehet se [...] në momentin e regjistrimit të këtij procedimi penal kam çmuar se vepra penale e kryer nga shtetasi ...

duhej të kualifikohej sipas nent 278/2 të Kodit penal dhe jo sipas nent 278/5 sepse në vlerësimin Tim për të kryer kualifikimin sipas figurës së veprës penale të parashikuar nga paragrafi i pestë i këtij neni duhet të vërtetoheshin njëkohësisht se transportimi është kryer me qëllim tregtimi fakt i cili nuk provohet nga aktet e ndodhura në dosje.[...]

7.2 Në përfundim të gjykimit në Kolegj, marrë në vlerësim shpjegimet e subjektit të rivlerësimit kërkitimi për këtë procedim penal në ankimin e datës 14.02.2023, gjendet i bazuar por duke vlerësuar mangësinë e konstatuar në vetëm këtë procedim penal ajo është e tillë që nuk justifikon zbatimin e nentit 61 pika 5 e ligjit nr.84/2016.

8. Për procedimin penal me nr. * , viti 2017**, në ankimin e Komisionerit Publik të datës 14.02.2023 është parashtruar se: [...] në vlerësim të akteve të administruara lidhur me procedimin penal nr. *** /2017, ndjekur nga subjekti i rivlerësimit, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, pasi ndryshimi i cilësimit të veprës penale gjatë gjykimit në seancën paraprake nga subjekti i rivlerësimit, nuk duket se është bërë mbi akte të reja, të ndryshme nga ato të administruara në fashikullin e procedimit [...] dhe se [...] elementet e këtij procedimi, në raport dhe me gjetjet e tjera, duhen vlerësuar dhe trajtuar si situata, të cilat mund të ndikojnë në cenimin e besimit të publikut, në kuptim të nentit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 [...].

8.1 Subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e depozituara në Kolegj në datë ** .06.2025, regjistruar me nr. ** / * prot., ndër të tjera shprehet se: [...] Në vazhdim dua të sjell në vëmendjen tuaj se gjykimi i kësaj çështje penale **ka përfunduar duke u deklaruar fajtor dy të pandehurit sipas neneve 76 e 22 të Kodit Penal duke e gjetur të drejtë cilësimin juridik të veprës penale të kryer që prokurori i çështjes ka saktësuar para gjyqtarit paraprak dhe për të pandehurin tjetër madje ka marrë dhe formën e prerë me vendimin me nr.*** akti, datë ** .07.2024 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm [...].**

8.2 Në përfundim të gjykimit në Kolegj, marrë në vlerësim shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe provën e paraqitur prej tij, shkurtim vendimi me nr. *** akti, nr. *** vendimi, datë ** .07.2024 i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, rezulton i shëruar shkaku ankimor i parashtruar në ankimin e datës 14.02.2023 dhe në përfundim nuk konstatohen mangësi në aspektin e ndërmarrjes së hetimit në mënyrë logjike dhe të plotë për të ushtruar ndjekjen penale dhe përfaqësuar akuzën në gjyq. Kontrolli gjyqësor i hetimit të këtij procedimi penal ka rezultuar me vendim të formës së prerë, ku në rezultatin fundor është vërtetuar kërkesa e subjektit të rivlerësimit për ndryshimin e akuzës.

8.3 Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka vendosur lënie në fuqi të vendimit nr.*** , datë ** .11.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me këto ndryshime: Dënimin e të pandehurit *** ** për kryerjen e veprës penale të “vrasje me dashje” të mbetur në tentativë, të kryer në

bashkëpunimi të parashikuar nga nenet 76-22-25 të Kodit Penal me 5 vjet e 6 muaj burgim. Dënimi i të pandehurit *** *** me 4 vjet burgim për kryerjen e veprës penale të “vrasje me dashje” të mbetur në tentativë, të kryer në bashkëpunim të parashikuar nga nenet 76-22-25 të Kodit Penal.

8.4 Në gjendjen që janë aktet aktualisht në gjykimin në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, rezultojnë se shtetasi *** *** është dënuar me vendim penal të formës së prerë të datës **.07.2024, për veprën penale për të cilën subjekti i rivlerësimit ka kërkuar ndryshimin e akuzës në seancën paraprake, ndërkohë që në momentin e ankimit të datës 14.02.2023 nga aktet në dosje ishte administruar vendimi i datës **.07.2022 i Gjykatës së Apelit Tiranë i cili kishte vendosur prishjen e vendimit nr. *** , datë **.06.2021 dhe kthimin e çështjes për rigjykim.

I. Kërkimi i ankimit

9. Nga sa u parashtrua më sipër, në vlerësim të përgjithshëm të procedurave të procesit të rivlerësimit, ashtu sikurse dhe praktika ka treguar, kërkimi i ankimit i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, kundrejt juridiksionit kontrollues të Kolegjit, mund të jetë alternativ kur rrethanat faktike dhe juridike e lejojnë atë.

10. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në vlerësimin tërësor të të gjitha provave, të administruara dhe të konfirmuara gjatë shqyrtimit dhe hetimit gjyqësor të kësaj çështjeje, bazuar në dispozitën e pikës 7 të nenit F të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 66, pika (1), shkronja (a), të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ana e Kolegjit të vendosë:

- Lënien në fuqi të vendimit nr.600, datë 19.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Robert Kote.

DREJTUESI I PROKURORISË

Altin DUMANI

PROKURORI I AUTORIZUAR

Klodjan BRAHO